

Fjalë e mbajtur e kryetarit Hivzi Islami në mbledhjen komemorative të ASHAK-ut me rastin e vdekjes së anët. korrespondent Ruzhdi Pllana, 21. 02. 2015

E nderuara familje Pllana,  
I nderuar Kryeministër i Republikës,  
Të nderuar kolegë dhe miq,  
Zonja dhe zotërinj,

Sapo e përcollëm për në banesën e fundit akad. Engjëll Berishën, na erdhi lajmi tjetër i hidhur se nga jeta u nda anëtari korresp. i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Prof. dr. Ruzhdi Pllana. Jemi sot këtu për t'i bërë nderimet e fundit Profesorit Pllana, specialistit të spikatur në fushën e gjeoshkencave, veçanërisht në disiplinat e gjeografisë fizike - hidrologjisë, klimatologjisë, speleologjisë, gjeomorfologjisë, mjedisit jetësor dhe metodologjisë e teknikave kërkimore të resurseve natyrore të Kosovës. Si hulumtues i zellshëm dhe si pendë e re në këto fusha arriti të ngrihej dhe afirmohej edhe jashtë kufijve të Kosovës, duke u bërë pjesë e qarqeve të njohura shkencore-hulumtuese në rajon dhe më gjerë. Nuk ka dyshim se pa prof. Pllanën gjeoshkencat te ne dhe veçanërisht studimet mbi ujërat dhe klimën e Kosovës, gjeotrashëgiminë e saj dhe rreziqet natyrore do të ishin shumë të varfra, madje edhe të panisura. Për këto probleme na la shumë dorëshkrime, gati të finalizuar, por dhe të papërfunduara. Nga dashuria e madhe për natyrën e Kosovës, e bëri edhe një vilë modeste në Brezovicë, prej nga i vrojtonte dhe i studionte fenomenet dhe ritmet e caktuara të natyrës. Ishte një adhurues i madh i alpinizmit dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në të.

Prof. Ruzhdi Pllana ishte personalitet që kontribuoi shumë dhe në sferën arsimore-edukative, nga shkolla e mesme deri te Universiteti i Prishtinës, duke drejtuar shumë kandidatë në diploma, në studimet e magjistraturës dhe të masterit dhe në doktorate të shkencave, dhe duke hartuar edhe tekste për ta. U shqua edhe në jetën publike, në udhëheqjen me sukses të institucioneve shkencore-pedagogjike dhe në mbrojtjen e kauzës sonë.

Mirësia, toleranca dhe njerëzia ishin veçori të dalluara të prof. Pllanës, sikundër dhe raportet e tij me kolegët, bashkëpunëtorët, studentët dhe njerëzit e tjerë me të cilët kishte kontakte. Duke respektuar çdo mendim të tjetrit, ishte shumë i përshtatshëm për bashkëpunim dhe i gatshëm në çdo moment që të ofronte ndihmë për secilin atje ku ishte e mundur, veçanërisht ndihmë për kolegët dhe bashkëpunëtorët.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë prindin, gjyshin, vëllain, mikun dhe kolegun tonë të dashur anët. korresp. Prof. Ruzhdi Pllanën.

Lavdi!

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së Prof. Ruzhdi Pllanës, si dhe të gjithë kolegëve, miqve dhe shokëve të tij të shumtë nga gjithë Kosova dhe bota shqiptare. Akademisë dhe familjes i kanë arritur edhe disa telegrame ngushëllimi. Në pamundësi që t'i lexojmë të gjitha telegramet, po e lexojmë vetëm telegramin e Presidentes së Republikës znj. Jahjaga dhe telegramin e Ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, prof. Arsim Bajramit.

Për jetën dhe veprën e Prof. Ruzhdi Pllanës do të flasë sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Fejzullah Krasniqi.